



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALFRED J. VASIL  
ADRESA NR.10, BLV"GJERGJ  
FISHTA", NR.88, NR.1, NR.1  
TEL: 672018025

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 416

Nr. koleksioni: 176

Tirane më 21/10/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022051320020830806



*Handwritten signature*



A2022051320020830906

Taksa e pulles  
U PAGUA



## KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

( TË SHOQËRISË “SOLAR ENERGY CELLS” SH.P.K)

Sot më datë 21 te muajit Tetor te vitit 2022 (dymijë e njëzet e dy), para meje noterit publik Alfred J. VASIL, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati E-88, kati i dyte, zyra nr. 1, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” shpk, me kushtet e mëposhtme:

### SHITES:

Florjan Almadhi, atësia Mehdi, amësia Fatime, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Shkozë; Nd. 317; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; lindur më 15/02/1989, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035562482 dhe nr. personal I90215063D, i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut të shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” shpk, me 4% te kuotave te kapitalit. .

### BLERES:

Aleks Hasa, atësia Enver, amësia Rabije, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës dhe banues në Kamez, me adresë Rr.Abaz Shehu ; Nd. 21; H. 1; Paskuqan; Kamëz, lindur më 10/06/1979, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037043500 dhe nr. personal H90610109B, i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut të shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” shpk, me 90 % te kuotave te kapitalit .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

### Kushtet Paraprake

- Shoqëria “SOLAR ENERGY CELLS” shpk, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), date regjistrimi 22.02.2022, me Certifikatë Regjistrimi NUIS M26422204I me zyrë qendrore në Vlore, Bulevardi Ismail Qemali, pallati Kali Trojes, kati 1; me kapital të regjistruar 100.000 (njqind mije) lekë, Nr. pergjithshem i kuotave 3; me ortak z. Aleks Hasa , zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 90 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë; z. Florjan Almadhi, zoterues i 1 (nje) kuote, e cila perben 4% te kapitalit te regjistruar te shoqerise; znj. Vojushe Dalipaj , zoteruese e 1 (nje) kuote, e cila perben 6% te kapitalit te regjistruar te shoqerise; me administrator z. Florjan Almadhi.
- Pala shitëse është e interesuar të shesë pjesën e kuotës e cila përfaqëson 4% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” shpk dhe pala blerëse

*Handwritten signature*

*Handwritten signature*



A2022051320020830806

duke qene per me teper pjese aksionare e shoqerise eshte e interesuar te bleje kete pjese te kuotes;

- Palët paraprakisht kanë rënë dakord që çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse në llogarinë bankare të shitesit.

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

## II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Florjan Almadhi, i shet palës blerëse z. Aleks Hasa pjesën prej 4 % të kapitalit që ai zoteron. Për efekt të kësaj shitjeje kuota e zotëruar nga z. Florjan Almadhi pjesëtohet sipas të dhënave sipërpermendur dhe pas shitjes shoqëria do të ketë 3 kuota, dy të zotëruara nga z. Aleks Hasa, e cila do të përbëjë 94 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk dhe njëra e zotëruar nga znj. Vojushe Dalipaj e cila do të përbëjë 6 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në QKB, ortakët e shoqërisë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk, do të jenë:

- Z. Aleks Hasa, zotëruar i 2 (dy) kuotave e cila përfaqëson 94 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk;
- Znj. Vojushe Dalipaj, zotëruar e 1 (një) kuote e cila përfaqëson 6 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk.

## III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së pjesës së kuotës objekt i kësaj kontrate, është 2.000 (dy mijë) leke. Kjo shume do të paguhet perkatesisht nga z. Aleks Hasa i cili duhet të derdhe në favor të z. Florjan Almadhi shumën 2.000 leke. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse brenda 24 orëve nga nënshkrimi i kontratës në llogarinë bankare të z. Florjan Almadhi.

## IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala shitëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në nga data e nënshkrimit të kontratës e me tej nuk kanë me të drejtë të ketë akses në asnjë prej dokumentave juridik, financiar dhe teknik të shoqërisë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk.

## V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerjeje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe z. Aleks Hasa e Vojushe Dalipaj behen ortakët në shoqërinë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk, duke zotëruar secili perkatesisht 94 % dhe 6 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e pjesën e kuotës e cila përfaqëson 4 % të kapitalit të shoqërisë "SOLAR ENERGY CELLS" shpk dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse z. Aleks Hasa.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pese) njesi origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.



## BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;  
Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;  
Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

## ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës;- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” - Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë “SOLAR ENERGY CELLS” Sh.p.k.. - Certifikatë personale e palës Shitëse; - Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

## DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

## PALËT KONTRAKTUESE

### SHITES

Florjan Almadhi, ortak me 4% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” shpk .

*Florjan Almadhi*

### BLERES

Aleks Hasa, ortak me 90 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “SOLAR ENERGY CELLS” shpk .

*Aleks Hasa*



NOTER

ALFRED J. VASIL

*Alfred Vasil*





**VENDIM ASAMBLEJE NR. 2/2022**

**“Solar Energy Cells” shpk**

**NUIS : M26422204I**

Sot me 20.10.2022, ne seline qendore te shoqerise me adrese në Vlore Blv. Ismail Qemali, Pallati Kali i. Trojes, Kati 1 ,9401, eshte mbledhur asambleja e ortakeve e thirur nga Ortaku i shoqerise Florjan Almadhi, i cili me kompetencat qe i jep statuti kerkon te filloje proceduren per shitjen e aksioneve te shoqerise “Solar Energy Cells” shpk, bashkeaksionerit Aleks Hasa e cila ka shfaqur interes.


Per sa me siper, asambleja **Vendosi**:

- Shitjen e te gjithë pjesës së aksioneve të Florjan Almadhit shtetasit Aleks Hasa, për vlerën 2000 leke.

Ortaket

Aleks Hasa

Florjan Almadhi



## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M26422204I	
2. Data e Regjistrimit	22/02/2022	
3. Emri i Subjektit	SOLAR ENERGY CELLS	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	16/02/2022	
6. Kohëzgjatja	Nga: 16/02/2022	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Vlore Vlore VLORE Blv."Ismail Qemali", Pallati Kali i Trojës, Kati 1 9401, Qyteti Vlorë, Qarku Vlorë, Shqipëri.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	3,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndërtimi, Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjise elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjise elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmese. Përfshirë dhe pa u kushtezuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet përgjegjëse Shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shitja me shumicë dhe pakicë e energjise elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjise elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjise jashtë vendit.	
10. Administratori/ët	Florjan Almadhi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/02/2022	Deri: 16/02/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	AleksHasa	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 90.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	

12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	90,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	FlorjanAlmadhi	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 4.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	4,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Ortakët	VojusheDalipaj	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 6.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	6,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: SOLAR ENERGY CELLS E-Mail: floralmadhi@hotmail.com Telefon: 0692164403	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 21/10/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Data : 26-05-2022

Dega: 001-Dega Rruga e Kavajes  
Arka/Nr: FLK-0033  
Veprimi: 20220526Keti.Flamuraj00141469  
Ref: 20220526Keti.Flamuraj00141469

### Depozitim Per te Trete

Urdheruesi : **ALEKS ENVER HASA**  
Perfituesi : **FLORJAN MEHTI ALMADHI** Nr Llogarise : **0000472652**  
Komision **ALL 125.00**  
Totali Ne Llogari : **ALL 2,000.00**  
Shuma e Klientit : **ALL 2,125.00** Kursi : **1.00**  
Pershkrimi i Veprimi : **ALEKS HASA KALIM SIPAS KONTRATES NR REP 176, NR KOL 76/4 DT 18/05/2022 PER SHITJE TE AKSIONEVE**

Sasia	Prerjet	Vlera	
1	2,000.00	2000.00	
1	500.00	500.00	
1	200.00	-200.00	Kusur
1	100.00	-100.00	Kusur
1	50.00	-50.00	Kusur
1	20.00	-20.00	Kusur
1	5.00	-5.00	Kusur
Totali :		<b>2,125.00</b>	

Arketari

Keti Flamuraj

23 MAY 2022

Klienti

#### Rifreskoni kontaktet tuaja!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen-më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products and services, and other.